




| | |
|---|-------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT | |
| AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE | |
| ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. | <u>2-D/DPK</u> |
| Dep. | <u>01-1635/13</u> |
| Dep. | <u>01-1635/13</u> |
| Nr. I faq. | <u>02</u> |
| Broj stranica | <u>02</u> |
| Nr. pages | <u>02</u> |
| PRISHTINE | |
| Nr. Prot. | <u>01-1635/13</u> |
| Br.Prot. | <u>01-1635/13</u> |
| Prot No. | <u>01-1635/13</u> |
| Data | <u>31.05.2013</u> |
| Datum | <u>31.05.2013</u> |
| Date | <u>31.05.2013</u> |



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **29.05.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mylllet rasti me Nr. AKK-03-242/13 për znj. Mirlinda Ahmeti – Drejtor në Zyren e Auditorit të Përgjithshëm, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konflikti të intersit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-242-13, për Zyrtaren e lartë, znj. Mirlinda Ahmeti – Drejtor në Zyren e Auditorit të Përgjithshëm, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligi Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-242/13, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtarja e lartë, znj. Ahmeti së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës zyrtarja është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konflikti të interesit.

Zyrtarja e lartë, znj. Ahmeti është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, ose edhe do ta shuaj në tërsi këtë biznes për arsy se ka kohë që ai biznes është pasiv, në mënyrë që të vazhdoi të ushtroj funksionin e saj publik, pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë, pas këtij takimi, znj. Ahmeti në Agjenci ka sjellur informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI-03-1495-13), në të cilën shihet se biznesi Qendra për edukim parashkollor “Folea” në të cilin znj. Ahmeti kishte funksion të personit të autorizuar tashmë është shuar në mënyrë vullnetare.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korruptionit

/ Hasan Preteni / 